

NDIHMJA EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË

<u>Emri i Shërbimit</u>	Kërkesë për përfitimin e ndihmës ekonomike
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	<p>“Ndhmë ekonomike” nënkupton mbështetjen financiare të familjeve në nevojë. Ndhmja ekonomike, që përfitojnë familjet në nevojë, është e plotë kur mungojnë të ardhurat krejtësisht dhe e pjesshme kur siguron te ardhurat të pamjaftueshme.</p> <p>Përfitojnë ndihme ekonomike:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Familjet pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme; b. Jetimet e papune, mbi 25 vjeç; c. Jetimet e moshës 18-25 vjeç, te cilët nuk janë te vendosur ne institucionet e shërbimeve shoqërore ose nen kujdestari; ç. Prindërit e fëmijëve te lindur trinjake e me shume, qe u përkasin familjeve ne nevojë. <p>Qytetarët që trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të dorëzojnë dokumentet për përfitimin e saj në rajonin administrativ përkatëse nga data 1 deri në 15 të çdo muaji, nga ora 09:00 - 13:00.</p> <p>Familjet që pretendojnë të trajtohen për herë të parë me ndihmë ekonomike duhet të dorëzojnë dokumentet më datën 16 të çdo muaji pranë Drejtorisë së Kujdesit Social ne Bashki.</p>
<u>Baza ligjore:</u>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ▪ Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 Kodi i Procedurave Administrative ▪ Ligji nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbimet shoqërore” ▪ Ligj nr. 47/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar ▪ Vendim nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”
<u>Përfituesi</u>	Qytetarët
<u>Zyra Përqejëse</u>	DKS – Drejtoria e Kujdesit Social, Sektori i Pagesave Kesh
<u>Afati</u>	20 ditë
<u>Tarifa</u>	Nuk ka tarifë
<u>Dokumente të nevojshëm</u>	<p>Dokumentacioni bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Deklaratën për gjendjen social-ekonomike te familjes, e cila plotësohet, nga kryefamiljari një here ne vit, si dhe ne rastet kur familja përfituese rikthehet ne skemën e ndihmës ekonomike. ✓ Deklaratën qe plotësohet, detyrimisht, çdo muaj; ✓ Certifikatë familjare për ndihmë ekonomike; ✓ Librezë pune ose deklarimi që nuk ka qenë asnjëherë i punësuar; ✓ Vërtetimin si pune kërkues te papune, për te gjithë anëtarët e afte për pune te familjes, qe aplikojnë për ndihme ekonomike. Ky vërtetim lëshohet nga Zyra e Punës, çdo tre muaj; ✓ Certifikatën e pronësisë, te lëshuar nga Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme; ✓ Dokumentacioni i ndihmës ekonomike për familjet qytetare; ✓ Certifikatë familjare ku shënohet familje e vjetër dhe për ndihmë ekonomike;

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Vërtetim si banor i rajonit; ✓ Vërtetim nga kadastra që nuk ka tokë; ✓ Vërtetim papunësie për anëtarët e familjes mbi 18 vjeç; ✓ Vërtetim i periudhës së trajtimit me pagesë papunësie; ✓ Librezat e punës origjinale (fotokopje e faqes së parë dhe të fundit për dorëzim); ✓ Dokumentacioni për familjet që kanë ndryshuar vendbanimin nga fshati në qytet: ✓ Dosja e përfituesit (ku të jetë trajtuar deri në momentin e shpërnguljes) ; ✓ Libreza e punës (kur përfituesi ka ardhur për arsye të kërkuara ose të detyruara nga shteti); ✓ Certificate familjare e fshatit; ✓ Deklaratat mujore të periudhës së trajtimit dhe vjetorja, të firmosura nga administratori. ✓ Vërtetim që konfirmohet nga Zyra Rajonale, i cili përmban masën e ndihmës ekonomike dhe periudhën e trajtimit, e firmosur dhe vulosur nga drejtori i Zyrës Rajonale, Kryetari i Komunës, administratori. ✓ Vërtetim nga Komuna për sipërfaqen dhe kategorinë e tokës (firmosur dhe vulosur nga Kryetari i Komunës dhe Shefi i Kadastrës) ✓ Certificate e pronësisë nga hipoteka ose negativi, në mungesë të tyre tapia e tokës e firmosur, vulosur nga përgjegjësi i kadastrës dhe Kryetari i Komunës. ✓ Dokumentet e përfitimit në qytet. ✓ Dokumentacioni për familjet që kanë ndryshuar vendbanimin nga një qytet në një tjetër: ✓ Certificate familjare e vendbanimit të mëparshëm ku shënohet data e largimit; ✓ Deklaratat mujore të periudhës së trajtimit dhe vjetorja, të firmosura nga administratori; ✓ Vërtetimi nga Zyra rajonale që përmban masën e ndihmës ekonomike dhe periudhën e trajtimit, firmosur nga Drejtori i Zyrës Rajonale, Kryetari i Bashkisë dhe administratori; ✓ Vërtetim si banor i rajonit të qytetit të mëparshëm dhe në kadastër që nuk ka tokë; ✓ Vërtetim papunësie për anëtarët e familjes mbi 16 vjeç ose shkolle nga qyteti që vjen. ✓ Vërtetim i periudhës së trajtimit me pagesë papunësie; ✓ Librezat e punës; ✓ Vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave nga qyteti që vjen; ✓ Vërtetim nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore nga qyteti që vjen; ✓ Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Automjeteve nga qyteti që vjen; ✓ Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nga qyteti që vjen; ✓ Dokumentet e përfitimit të qytetit pritës.
--	---